AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

SI DO TË PËRCAKTOHET VLERA E DEPOZITAVE TE ASETEVE NË SHITJE?

Vlera e depozitave për asetet në shitje do të përcaktohet sipas çmimeve minimale dhe atë në dy kategori:

Për asete me çmim orientues ≤ 100,000 €

Depozitë 10% e vlerës

Për asete me çmim orientues > 100,000 €

Depozitë 5% e vlerës

Për asetet e luajtshme

Depozita përcaktohet nga Agjencia

PSE JANË KËTO NDRYSHIME TË RËNDËSISHME?

- Rrit transparencën dhe siguron informim të plotë për ofertuesit
- Parandalon shitjet nën vlerë dhe siguron çmime të drejta

Informata mbi ndryshimin e rregullave të tenderit për SHITJEN E ASETEVE NË LIKUIDIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Divizioni për Marketing dhe Tender Publik

+383 (0) 38 500 400
lok. 2059 dhe 1090

marketing@pak-ks.org;
info@pak-ks.org

Rruga "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

www.pak-ks.org

Çfarë nënkupton ÇMIMI MINIMAL ORIENTUES?

- Çmimi minimal orientues nënkupton vlerën më të ulët të përcaktuar nga Agjencia për shitjen e një aseti.

SI PËRCAKTOHET ÇMIMI MINIMAL?

- Vlera e pronave e përcaktuar nga Ministria e Financave, për qëllime tatimit në pronë, dhe
- Mesatarja e shitjeve të AKP-së në 3 vitet e fundit

Sqarim:

Nëse vlera sipas zonave dhe niveleve të vlerave është shumë e ulët ose nuk ekziston, atëherë Agjencia do të llogarisë çmimin minimal bazuar në çmimet mesatare të shitjeve të kaluara.

Ky çmim caktohet për të siguruar që një aset nuk shitet nën vlerën e arsyeshme.

Nëse nuk ka oferta mbi këtë çmim, procesi i shitjes do të përsëritet në valën e ardhshme të shitjes.

Për objekte që tenderohen, çmimi orientues prezantohet me €/m² (euro për metër), ndërsa për toka që tenderohen çmimi orientues prezantohet me €/ari (euro për ari).

ÇFARË KA NDRYSHUAR NË SHITJET E ASETEVE NË LIKUIDIM?

Të gjitha asetet për shitje do të kenë të publikuar:

ÇMIMIN MINIMAL ORIENTUES

KATEGORINË PËRKATËSE TË ASETIT

Cfarë nënkupton PËRCAKTIMI I KATEGORISË SË ASETIT?

Për çdo aset/pronë që shitet do të përfshihet kategoria e asetit:

Rezidenciale

Komerciale

Bujqësore

Industriale

Kriteret për kategorizimin e pronave janë:

shfrytëzimi aktual i pronës:

&

shfrytëzimi potencial i pronës në të ardhmen

Sqarim:

Kategorizimi i aseteve do të shërbej vetëm për qëllime të përcaktimit të çmimit minimal për shitjen e tyre dhe nuk do të ketë asnjë efekt tjetër në ndryshimin e kategorisë së aseteve në regjistrat e kadastrave.